



SBASHK Arsimimi sot

Shtator, 2024

Gazeta elektronike

SBASHK i dorëzoi 20,606 nënshkrime në Kuvendin e Republikës së Kosovës



Gjatë muajit shtator, SBASHK ishte kujdesur që t'a drejtojë kërkesën në Kuvendin e Kosovës për nismën qytetare, të përfundoj procedurat ligjore lidhur me këtë nismë qytetare, si dhe të mbledh nënshkrimet nëpër terren me ndihmën e anëtarësisë anë e kënd Kosovës...(faqe 3)

SBASHK takime me shefat e Grupeve parlamentare




Me qëllim që të informojë shefat e Grupeve Parlamentare, lidhur me nismën legjislativ nga qytetarët për miratimin e ...(faqe 4)

SBASHK takime me anëtarësinë



SBASHK ka vazhduar takimet konsultative me kryetarët e nivelit sindikal dhe të ...(faqe 5)

Vazhdohet me trajnimet sipas kërkesave të anëtarësisë



SBASHK vazhdon me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës në programet e licencuara nga MASHTI "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" dhe "Forcimi i kapaciteteve...(faqe 7)

SBASHK uron mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për vitin e ri shkollor



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në fillim të çdo viti shkollor, SBASHK-u u drejtohet mësimdhënësve, nxënësve e prindërve me urimin, që viti shkollor të ketë rrjedhë të mbarë dhe të ...(faqe 8)



Editorial

Nisma qytetare dëshmi e unitetit në SBASHK



Duke analizuar me kujdes shqetësimet e anëtarësisë sonë, lidhur me ndryshimet në skemat pensionale të financuara nga shteti, u fillua me mbledhjen e nënshkrimeve për iniciativën qytetare, për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04L-131, për skemat e pensioneve të financuara nga shteti, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08L-248. Detyrat që kishin marrë kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve, i kanë kryer me përpikëri dhe brenda pak ditësh janë mbledhur 20.606 nënshkrime, edhe pse për këtë nismë qytetare ishin të mjaftueshme 10.000 nënshkrime. Ky entuziazëm dhe mbledhja e një numri kaq të madh nënshkrimesh, pa numëruar edhe qindra të tjerë, që nuk i janë bashkuar numrit

të dorëzuar në takimin me Kryetarin e Parlamentit Glauk Konjufca, dëshmon për unitetin, e gatishmërinë e SBASHK-ut për angazhime në shërbim të anëtarësisë, e veçmas për ata që kanë punuar me vite e dekada në misionin e shenjtë, për edukimin e arsimimin e brezave e që tani kanë nevojë, për angazhimin tonë në emër të tyre dhe për mbështetjen nga institucionet e Kosovës.

Këtë angazhim e përkushtim të SBASHK-ut, në shërbim të pensionistëve e ka përshëndetur edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës Glauk Konjufca, duke përgëzuar SBASHK-un për këtë nismë qytetare në takimin kur i janë dorëzuar 20.606 nënshkrime dhe shkresat përcjellëse lidhur me këtë nismë qytetare.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Flasin ata që u angazhuan në organizimin e Peticionit për ndryshimin e Ligjit për skemat pensional



SBASHK gjatë muajit shtator, ka organizuar iniciativën qytetare për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04L-131 për skemat e pensioneve të financuara nga shteti, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08L-248.

Lidhur me këtë proces, SBASHK ka angazhuar një numër të madh të anëtarëve duke organizuar mbledhjen e mbi 20.600 nënshkrimeve në të gjitha komunat e Kosovës, disa prej të cilëve do t'i përmendim në këtë bashkëbisedim.

Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, tha se iniciativa qytetare e realizuar nga SBASHK është shumë e qëlluar pasi ka për qëllim përfshirjen e mësimdhënësve por edhe qytetarëve tjerë të larguar nga puna në vitet e okupimit, në listën e pensioneve kontributdhënëse.

Shala tha se është shumë e rëndësishme që kjo iniciativë qytetare të shqyrtohet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe të dëgjohet zëri qytetar ngase sipas saj do të fitohet një e drejtë e mohuar padrejtësisht për të gjithë mësimdhënësit por edhe qytetarët tjerë të larguar

nga puna gjatë viteve të okupimit.

Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, është një ndër më të angazhuarit në organizimin e peticionit të dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ymeri është shprehur se ish-mësimdhënësit të cilët janë larguar nga puna në vitet e okupimit të Kosovës si dhe ata që punojnë aktualisht, kur të arrijnë moshën e pensionimit duhet të gëzojnë pensionin kontributpagues nga shteti i Kosovës, anipse janë larguar dhunshëm nga ish-regjimi serb.

Ymeri tha se brenda një kohe rekord prej vetëm një jave është arritur të mbledhet dyfishi i numrit të kërkuar me Ligj për Peticione dhe nga 10.000 nënshkrime të nevojshme, SBASHK ka arritur të mbledh 20.606 nënshkrime nga qytetarët. Ymeri tregoi se plotësim-ndryshimi i këtij ligji nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës do t'u mundësonte shumë qytetarëve të Kosovës që në moshën e pensionimit të gëzojnë një pension të dinjitetshëm dhe t'u shpërblehet munda dhe kontributi i dhënë për shtetin e Kosovës.

Kurse zyrtari ligjor në SBASHK, Blendor Shatri, tha se mësimdhënësit e Kosovës të larguar nga puna gjatë viteve '90 duhet të fitojnë të drejtën ligjore për pensione kontribupaguese dhe se sipas tij një e drejtë atyre u takon.

Gjatë muajit

SBASHK i dorëzoi 20,606 nënshkrime në Kuvendin e Republikës së Kosovës



Gjatë muajit shtator, SBASHK ishte kujdesur që t'a drejtojë kërkesën në Kuvendin e Kosovës për nismën qytetare, të përfundoj procedurat ligjore lidhur me këtë nismë qytetare, si dhe të mbledh nënshkrimet nëpër terren me ndihmën e anëtarësisë anë e kënd Kosovës. Nënshkrimet e grumbulluara nga terreni, kryetarët e niveleve komunale të SBASHK-ut i kishin dorëzuar në

mënyrë të organizuar në zyrën qendrore të SBASHK-ut, një javë para dorëzimit në Kuvend, ku edhe ishin përgatitur të gjitha listat në mënyrën e kërkuar me Ligjin për Peticione por edhe Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, për t'u dorëzuar në mënyrë solemne të hënën e 30 shtatorit 2024.

Organizimi i nismës legislative nuk la vend për mëdyshje të unitetit në SBASHK, duke u mbledhur mbi 20.606 nënshkrime për të kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08L- 248. Gjatë vetëm një jave SBASHK-u, arriti ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës nismën qytetare me 20.606 nënshkrime të mbledhura në terren nga anëtarësia e SBASHK-ut, por edhe qytetarë tjerë.



Për dorëzimin e nënshkrimeve në Kuvendin e Kosovës, përfaqësuesit e SBASHK-ut, u pritën nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca, ku dhe i pranoi në menyre solemne 20.606 nënshkrimet e mbledhura në kuadër të nismës qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale. SBASHK me këtë nismë synon të adresojë ndryshimet në Ligjin e skemave pensionale që kanë të bëjnë me kërkesën që vitet e 90-ta dhe vitet pasuese deri kur ka filluar së funksionuari Trusti Pensional i Kosovës të njihen si kontributdhënës që do të ishte ndihmesë, jo vetëm për të punësuarit në arsim, por edhe për gjithë të tjerët që të arrijnë vitet e duhura kontributpaguese dhe të gëzojnë pension të punës, e jo të mbesin vetëm me pensionin e pleqërisë pas dekadave të kaluara në punë.



Ndërsa, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca në bashkëbisedë me përfaqësuesit e kësaj nisme qytetare ka vlerësuar angazhimin e tyre duke u shprehur se do të angazhohet që kjo nismë të kalojë procedurat e duhura dhe sa më shpejtë të gjendet te deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, ka falënderuar Kryetarin e Parlamentit të Kosovës për pritjen duke lutur deputetët e Kuvendit të Kosovës, që ta marrin me prioritet këtë nismë qytetare, në mënyrë që mesimdhënësit edhe ish-punonjësit e Kosovës gjatë kësaj periudhe të gëzojnë të drejtën e fituar. Jasharaj në deklaratë para gazetarëve, veç tjerash, ka theksuar, se këto mijëra nënshkrime janë mbledhur brenda një afati shumë të shkurtër, për të kërkuar falje nga veprimtarët kudo në Kosovë, që kanë mbledhur edhe qindra nënshkrime. e të cilat nuk janë pjesë e këtyre nënshkrimeve të dorëzuara në Parlament, sepse jemi angazhuar që të jemi në hap me kohën.



Bartësit e kësaj nisme qytetare, por edhe gjithë të nënshkruarit, besojnë se nisma do të hasë në mbështetje të shumicës së deputetëve dhe kështu do t'u rikthehet e drejta e fituar punëtorëve të arsimit për vitet e 90-ta, duke u konsideruar prapë si vite kontributdhënës, e po ashtu të tilla të numërohen edhe vitet pasuese deri me funksionalizimin e Trustit pensional në korrikun e vitit 2002. Kjo nismë qytetare, këtë të drejtë e kërkon edhe për gjithë ata që dhunshëm janë dëbuar prej pune nga pushtuesi serb në vitet 90-ta.

SBASHK-u po ashtu pritet që ta dorëzojë në MASHTI Draftin e Kontratës së re Kolektive të Arsimit, e cila është finalizuar pas diskutimit publik me anëtarësinë, me qëllim që të nisë negociimi për të dhe të krijohen kushtet për nënshkrim nga MASHTI dhe SBASHK në kohën më të shpejtë të mundshme.

SBASHK takime me shefat e Grupeve parlamentare



Me qëllim që të informojë shefat e Grupeve Parlamentare, lidhur me nismën legislative nga qytetarët për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.08L- 248 dhe për të kërkuar mbështetjen e të gjithë deputetëve nga këto subjekte politike, pas takimit me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi dhe me shefen e Grupit Parlamentar të VV-së, Mimoza Kusari Lila,



përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë pasur takime të ndara edhe me shefin e Grupit Parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri dhe me shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri.

Në të gjitha këto takime të kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e zyrtarin ligjor Blendor Shatri, kanë informuar shefat e Grupeve Parlamentare lidhur me arsyen e kësaj nisme legislative me qytetarë, për angazhimet e deritashme dhe për aktivitetet që do të bëhen deri te momenti i dorëzimit të mijëra nënshkrimeve në mënyrë solemne te kryetari i Parlamentit të Kosovës Glauk Konjufca.


SBASHK takime me anëtarësinë

SBASHK ka vazhduar takimet konsultative me kryetarët e nivelit sindikal dhe të universiteteve edhe gjatë muajit shtator, ku ka analizuar realizimin e detyrave konkrete në shërbim të kërkesave të anëtarësisë.

Diskutimet kryesore në këto takime kanë qenë, informimi i anëtarësisë se përfaqësuesit e SBASHK-ut i kanë dërguar disa herë shkresa zyrtare kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe ministres për Arsim, Arbërie Nagavci me kërkesat që urgjentisht të ngritet vlera e koeficientit të pagave për së paku 30% dhe të futet në zbatim që nga shtatori i këtij viti.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, bashkë me nënkryetaren znj. Vjollca Shala e koordinatoren për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri, kanë informuar përfaqësuesit e të punësuarve në arsim, që nga çerdhet e deri në universitete, se duke realizuar detyrat nga takimet paraprake më 3 shtator i kanë dërguar shkresë zyrtare kryeministrit Kurti dhe ministres Nagavci me kërkesat: që urgjentisht të ngritet vlera e koeficientit të pagave për së paku 30% dhe të futet në zbatim që nga shtatori i këtij viti. Po ashtu është kërkuar që të zbatohet menjëherë vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. AGJ 2113/23 i datës 16.01. 2023 e veçmas, ai lidhur me pagesën e viteve të përvojës së punës, në mënyrë

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë kërkuar edhe në këto takime që deputetët e këtyre dy subjekteve politike ta mbështesin këtë nismë legislative duke e votuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08L- 248. Shefat e këtyre Grupeve Parlamentare kanë përgëzuar SBASHK-un për këtë aktivitet dhe janë shprehur të bindur se deputetët e Parlamentit të Kosovës do ta mbështesin dhe do ta votojnë këtë Projektligj, që është nismë legislative nga qytetarët.



që edhe 15 vitet e para të punës për të gjithë punëtorët e sektorit publik nga 0.25 %, të kthehet si ka qenë në 0.5%. Në fund të këtyre shkresave, SBASHK-u ka shprehur gatishmërinë për takim me kryeministrit Kurti dhe ministren Nagavci, për të dhënë sqarime shtesë për këto dy kërkesa legjitime të anëtarësisë.

Po ashtu, pjesëmarrësit janë informuar se grupet punuese kanë përgatitur gjithë materialin për nismën qytetare lidhur me ndryshimet në Ligjin e skemave pensionale që ka të bëjë me kërkesën që vitet e 90-ta dhe vitet pasuese deri kur ka filluar së funksionuari Trusti Pensional i Kosovës, të njihen si kontributdhënëse, që do të ishte ndihmesë jo vetëm për të punësuarit e arsim, por edhe për gjithë të tjerët që të arrijnë vitet e dhura kontributpaguese dhe të gëzojnë pension të punës, e jo të mbesin vetëm me pensionin e pleqërisë pas dekadave të kaluara në punë. Përfaqësuesit e SBASHK-ut, informatën për fillimin e kësaj nisme qytetare e kanë dorëzuar në zyrën gjegjëse të parlamentit të Kosovës duke shpallur kështu fillimin e aktivitetit për mbledhjen e numrit të duhur të nënshkrimeve nga punëtorët e arsimit, nga pensionistët, por edhe nga qytetarët e Kosovës për ta realizuar me sukses këtë nismë qytetare. Pjesëmarrësit e këtij takimi, kanë autorizuar zyrtarin ligjor të SBASHK-

ut, z. Blendor Shatri që të jetë përgjegjës për rrjedhën e mbarë të kësaj iniciative qytetare.

Takime me anëtarësinë janë mbajtur edhe në Ferizaj, ku u është dhënë mbështetje e fuqishme angazhimeve të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Pjesëmarrësit e këtij takimi në Ferizaj, ngriten shqetësimin e Kontratës Kolektive, për të cilën SBASHK u zotua, se do të formohet komisioni për hartimin e Draft-Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës dhe brenda javës të përfundoj ky angazhim, për ta dërguar pastaj për diskutim publik tek anëtarësia, dhe pastaj të bëjë draftin final për ta dorëzuar në MASHTI. Edhe në këtë takim është përkrahur iniciativa qytetare e SBASHK-ut për ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, për të mbledhur mbi 10 mijë nënshkrime nga anëtarësia dhe qytetarë të tjerë, për ta dërguar në Parlament për procedurat gjegjëse dhe për ndryshimet, duke kthyer pikën 6 të nentit 8 të Ligjit bazik. Pjesëmarrësit e këtij takimi përkrahën edhe kërkesën që t'i drejtohet MASHTI-t dhe Qeverisë, për ngritje të vlerës së koeficientit të pagave prej së paku 30% me rishikim të buxhetit të vitit 2024 ose me vendim të Qeverisë, por kjo ngritje të filloj së zbatuari me pagën e muajit shtator 2024. Pjesëmarrësit në këtë takim shprehën brengosje të thellë për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Ligjin e Pagave, sidomos për pagesën e përvojës së punës në 15 vitshin e parë, por ende të paguhen me 0.25%, edhe pse Kushtetuesja ka konstatuar, që kjo është shkelje kushtetuese dhe me këtë që nga hyrja në fuqi e Ligjit të Pagave, të punësuarit

dëmtohen me rreth 4% të pagës.

Takime të ngjashme janë organizuar edhe në Rahovec, Suharekë, Novobërdë, Shtime, Kaçanik, Dragash, Hani i Elezit, Vushtrri, Drenas, Viti, Malishevë, Lipjan, Gjakovë, Deçan, Gjilan, Mitrovicë, Fushë-Kosovë, Skenderaj, Prizren, Podujevë, Klinë e SUSHK, derisa takime pritet të mbahen edhe nëpër komunat tjera të Kosovës.

Në këto takime është ngritur shqetësimi i Kontratës Kolektive, për të cilën SBASHK u zotua se do të formohet komisioni për hartimin e Draft-Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës dhe brenda javës të përfundoj ky angazhim për ta dërguar pastaj për diskutim publik tek anëtarësia, dhe pastaj të bëjë draftin final për ta dorëzuar në MASHTI. Gjatë muajit shtator SBASHK ka organizuar edhe diskutim publik për Draft-kontratën e re Kolektive të Arsimit e cila ka qenë edhe në ueb-faqen e SBASHK-ut, prej ku janë pranuar edhe disa komnete nga anëtarësia e të cilat janë përfshirë në propozimin e dërguar MASHTI-t.



Sbashk Republika e Kosovës is with Ymer Ymeri and 34 others.

September 10 at 2:32 PM

Diskutim publik për Draft-kontratën e re Kolektive të Arsimit për anëtarësinë e SBASHK-ut

Të nderuara anëtare, të nderuar anëtarë, ju informojmë se komisioni ka përgatitur Draftin e parë të Kontratës së re Kolektive të Arsimit dhe sipas vendimit nga takimi me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve, Draftin po e vendosim në diskutim publik deri më datën 17.09.2024. Draftin e gjeni në linkun: <https://sbashk-rks.org/.../Draft%20Kontrata%20Kolektive...>

Ndërsa, propozimet e juaja për Draft-kontratën e re të Arsimit, mund t'i dërgoni në email-adresen info@sbashk-rks.org përmes formularit unik të cilin mund ta gjeni duke klikuar në linkun: <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx...>

Ju lusim, t'i jepni shënimet e kërkua sepse komisioni merr për bazë vetëm propozimet e pranuar nga anëtarësia e SBASHK-ut, të cilët i kanë plotësuar shënimet e kërkua.

[VIEW.OFFICEAPPS.LIVE.COM](https://view.officeapps.live.com)

view.officeapps.live.com




Vazhdohet me trajnimet sipas kërkesave të anëtarësisë



SBASHK vazhdon me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës në programet e licencuara nga MASHTI “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, me qëllim që mësimdhënësit të arrijnë suksese sa më të larta në punën e tyre, por edhe grumbullimin e kredive/pikëve të nevojshme për avancim në sistemin e arsimit.

Në kuadër të kësaj, SBASHK gjatë muajit shtator i ka organizuar tri grupe të trajnimeve për anëtarësinë e vet në programin: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, dy grupe të mësimdhënësve në Pejë dhe një grup në Prishtinë.



Në kuadër të mbajtjes së trajnimeve në qytetin e Pejës, kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Pejë, z. Isuf Lajçi kanë vizituar në ambientet e shkollës “8 Marsi” pjesëmarrësit e trajnimit për kompjuter. Kryetari Jasharaj nuk fshehu krenarinë dhe emocionet se po ndodhet në një vatër arsimore në të cilën punoi 32 vjet duke kujtuar se këtu në vitet e rënda të okupimit ishin zhvilluar shumë nga aktivitetet në shërbim të realizimit dhe amanetit të gjeneratave për gjuhën shqipe dhe për Kosovën shtet. Ai pastaj bashkë me kryetarin, z. Isuf Lajçi kanë përgëzuar trajnerin z. Burim Krasniqi dhe u janë përgjigjur edhe pyetjeve të pjesëmarrësve në këtë aktivitet të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

Poashtu edhe në Prishtinë, ka filluar trajnimi edhe për një grup të mësimdhënësve në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” I cili është mbajtur në ambientet e shkollës “Ismail Qemali”




nën udhëheqjen e trajnerit, Kadri Hyseni. Mësimdhënësit të cilët e kanë ndjekur trajnimin në Prishtinë, i ka vizituar koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, i cili u kujdes për mbarëvajtjen e trajnimit si dhe u dëshiroi mësimdhënësve arritje sa më të lartë të përvetësimit të njohurive në fushën e programeve kompjuterike Ëord, Excel dhe Poëer Point, të cilat janë pjesë e modeuleve në këtë trajnim.




Aktivitetet e SBASHK-ut nuk kanë të ndalur gjithandej nëpër komuna, gjatë kësaj periudhe edhe në Kacanik SBASHK mbajti testin me shkrim pas përfundimit të trajnimit në programin: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, i cili u organizua nga koordinatori për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri dhe znj. Nezafete Jakupi.

Testi me shkrim për një grup të mësimdhënësve-anëtarë të SBASHK-ut, u mbajt pas përfundimit të trajnimit në këtë program, të udhëhequr nga trajneri, z. Avni Krasniqi, por që nga fillimi e deri në përfundim të këtij trajnimi si çdoherë qëndroi edhe kryetari i SKAP Kaçanik, z. Islam Berisha i cili i përshëndeti pjesëmarrësit dhe organizatorët e këtij trajnimi duke ju uruar suksese.



SBASHK uron mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për vitin e ri shkollor



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në fillim të çdo viti shkollor, SBASHK-u u drejtohet mësimdhënësve, nxënësve e prindërve me urimin, që viti shkollor të ketë rrjedhë të mbarë dhe të arrihen shumë suksese në përpjekje për dije të reja. Në urimin e këtij viti thuhet:

Të nderuar mësimdhënës, nxënës dhe prindër po fillojmë edhe një vit shkollor për të vazhduar betejat për dije dhe arritje të reja. Edhe në këtë vit shkollor do të përballemi


me shumë sfida, por bashkërisht mund t'i tejkalojmë më lehtë.

Të nderuara anëtare, të nderuar anëtarë të SBASHK-ut, ne jemi në vazhdimësi të angazhimeve që me dialog të gjejmë zgjidhje meritore për kërkesat tuaja legjitime edhe pse nuk e kemi të lehtë sepse Qeveria vazhdon me qasjen e gabuar ndaj dialogut dhe ndaj sindikatave në tërësi.

Ne do të vazhdojmë me aktivitetet dhe me komunikimin me institucionet dhe palët tjera me qëllim që të realizojmë gjithë kërkesat e anëtarësisë, por nëse dialogu nuk jep asnjë rezultat, atëherë ne do të respektojmë vullnetin tuaj edhe për veprime sindikale, për të cilat vendosin përfaqësuesit tuaj që nga çerdhet e deri në universitete në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Urime viti i ri shkollor dhe na priftë e mbara bashkë e në SBASHK.

SBASHK –u anëtarësisë: Mos nënshkruani kontrata të reja të punës



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Ditët e fundit përsëri në disa komuna është aktivizuar kërkesa për nënshkrimin e kontratave të reja të punës, përkundër që mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar i kanë kontratat e punës me afat të pacaktuar.

Versionet që po qarkullojnë e që i posedon SBASHK-u, janë më të pafavorshme se kontratat ekzistuese dhe nuk janë në përputhshmëri me UA10/2015 për kontratat e punës për mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar.

Prandaj kërkojmë nga komunat që të ndalin presionin ndaj mësimdhënësve për nënshkrimin e këtyre farë versioneve të kontratave të punës që po qarkullojnë. Po ashtu, apelojmë te anëtarësia që kanë kontrata në kohë të pacaktuar, të mos i nënshkruajnë këto farë versione të kontratave të punës edhe përkundër presioneve që mund t'i kenë nga punëdhënësit.

SBASHK-u nuk i harron veprimtarët sindikal

Krahas shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u vazhdon me një traditë të veçantë duke i bërë bashkë e në një aktivitet veprimtarët sindikalë, që dikur ishin në ballë të aktiviteteve sindikale dhe në misionin e shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave. Këta veprimtarë ndjehen krenar me sindikatën e tyre dhe falënderojnë stafin qendror për këtë aktivitet, i cili ua mundëson atyre që të takohen me një-tjetrin e të kthejnë kujtesën nëpër vite e dekada për të kujtuar edhe momente të veçanta nga aktivitetet e shumta sindikale. Kështu ishte edhe këtë vit. Ata po buzëqeshnin e po bashkëbisedonin duke harruar për pak kohë edhe

problemet shëndetësore që sjell pleqëria. Ata ndjehen krenar dhe falënderojnë SBASHK-un që nuk po i harron dhe me vëmendje dëgjojnë për angazhimet tani duke përgëzuar sindikatën e tyre për gjithë këto arritje në shërbim të anëtarësisë. Këta veprimtarë bashkë me stafin qendror mbajten edhe një takim pune, që i ngjante atyre takimeve të dikurshme, që ata i organizonin e debatonin edhe për tema të nxehta të kohës e sjellin vendime sipas zërit të anëtarësisë.

Ky aktivitet do të vazhdojë edhe në të ardhmen, sepse SBASHK-u nuk i harron veprimtarët e vetë sindikal.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture